



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.179

31 dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.881, datë 12.12.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Bele 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 5569
Vendim i KM nr.882, datë 12.12.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Holtë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 5569
Vendim i KM nr.883, datë 12.12.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Veleshica 1”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 5570
Vendim i KM nr.884, datë 12.12.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Tujan”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 5570
Vendim i KM nr.885, datë 12.12.2007	Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Xhemi 02” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Verbë-Selcë” 5571
Vendim i KM nr.886, datë 19.12.2007	Për krijimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit të kualifikimit, për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik 5581
Vendim i KM nr.887, datë 19.12.2007	Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje 5582
Vendim i KM nr.888, datë 19.12.2007	Për miratimin e rregullave teknike “Për përcaktimin e kërkesave thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave” 5583
Vendim i KM nr.889, datë 19.12.2007	Për miratimin e rregullave teknike “Për përcaktimin e kërkesave thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të enëve të thjeshta nën presion” 5591

VENDIM
Nr.881, datë 12.12.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “BELE 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Bele 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 9 përqindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Griald” sh.p.k.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.882, datë 12.12.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “HOLTË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Holtë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 8.5 përqindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Ibrahimi” sh.p.k.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.883, datë 12.12.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “VELESHICA 1”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT,**

NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Veleshica 1”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit prej 8 përqindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Finage” sh.p.k.
 3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.884, datë 12.12.2007**

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “TUJAN”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës, “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Tujan”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit prej 9 përqindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Koja” sh.p.k.
 3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.885, datë 12.12.2007**

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “XHEMI 02” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “VERBË-SELÇË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë

18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues dhe shoqërisë “Xhemi 02”, sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Verbë-Selcë” sipas tekstit dhe aneksit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Republika e Shqipërisë
Zyra e Noterisë Tiranë
Nr. _____ Rep.
Nr. _____ Kol.

KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS “BOT” (NDËRTIM, SHFRYTËZIM, TRANSFERIM) PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALIT “VERBË-SELÇË”

Në Tiranë, më datë.....2007 (dymijë e shtatë), përpara meje notere....., e regjistruar në Dhomën e Noterisë Tiranë, me adresë në, u paraqitën Palët Kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktuar si “**Autoritet Kontraktues**” me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.127, datë 14.3.2007 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Verbë-Selcë”, që më poshtë do të quhet “Hidrocentrali”, përfaqësuar me autorizimin nr.1828/7, datë 14.9.2007 nga z.Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datëlindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi nr.NF 489018;

dhe

Shoqërisë “Xhemi 02”sh.p.k., regjistruar si person juridik me vendimin nr.28460, datë 29.10.2002 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori z.Baftiar Xhaja, për identitetin e të cilit u sigurova nga certifikata personale, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

HYRJE

Duke pasur parasysh që Qeveria e Shqipërisë:

a) i ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit ose rehabilitimit të hidrocentraleve të reja ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;

b) e konsideron ndërtimin e hidrocentraleve një element të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të energjisë;

c) e vlerëson formën “BOT” të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur stimulimin e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të reja me anën e kapitalit privat;

d) e angazhuar për ngritjen dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike;

e) mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;

f) me anën e legjislacionit në fuqi, rregullon dhënien me koncesion të hidrocentraleve dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.127, datë 14.3.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Verbë-Mesmal-Velçan””, autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit,

si dhe:

Koncesionari

a) është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit në komunën Gorë, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të zonës;

b) shoqëria “Xhemi 02” sh.p.k., zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare dhe organizative, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj kontrate;

c) ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit “Verbë-Selcë”, objekt i këtij koncesioni;

d) shoqëria “Xhemi 02” sh.p.k., ka marrë njoftim nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me anë të shkresës zyrtare nr.4630/1, datë 10.7.2007, për shpalljen fitues në procedurën e konkurrimit për koncesionin e hidrocentralit “Verbë-Selcë”;

Palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Përkufizime

Termat e mëposhtëm, kudo që do të përdoren në këtë kontratë, kanë kuptimet që jepen në vijim:

a) “Kontratë koncesioni” është kjo kontratë dhe anekset 1 dhe 2, bashkëlidhur kësaj.

b) “Autoriteti kontraktues” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

c) “Koncesionari” është shoqëria “Xhemi 02” sh.p.k., me seli në Pogradec.

ç) “Hidrocentrali” është hidrocentrali “Verbë-Selcë” dhe tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike, ku përfshihet vepra e marrjes, kanali i devijimit, baseni i presionit, tubacioni që dërgon ujin në turbina, ndërtesa e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të, nënstacioni dhe linja e transmetimit që bën lidhjen me rrjetin ekzistues, dhe gjithçka tjetër që lidhet dhe i shërben këtij hidrocentrali.

d) “Kontratat e sipërmarrjes” janë të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari me sipërmarrësit për kryerjen e punimeve.

dh) “Licencë” është akti administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik, për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kriteret objektive të kualifikimit.

e) “Tarifa koncesionare” është sasia e energjisë elektrike që i ofrohet pa pagesë shtetit.

ë) “Projektide” është dokumentacioni teknik e ekonomik për planifikimin, financimin, projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit.

f) “Projekti i zbatimit” është projekti i detajuar inxhinierik, i cili përmban parametrat, karakteristikat dhe specifikimet përfundimtare të hidrocentralit.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është projektimi, ndërtimi, shfrytëzimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave të kësaj kontrate.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentralit

Karakteristikat e hidrocentralit janë, si më poshtë:

Kuota e veprës së marrjes +1562 m.sl

Kuota e ndërtesës së centralit +725 m.sl

Fuqia e instaluar
Energjia e prodhuar

2.8 MW (2x1.4) MW
16 mln kWh/vit.

Neni 4

Afat i koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion hidrocentralin, për një afat kohor prej 35 vjetësh, sipas shkronjës “b” të nenit 27 të ligjit nr.9663, datë 18.6.2006 “Për koncesionet”. Ky afat fillon pas miratimit të kësaj kontrate sipas nenit 17.

Neni 5

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

a) të asistojë Koncesionarin pranë çdo institucioni, organi a agjencie shtetërore, qendrore a vendore, kur është e nevojshme, për marrjen e licencave, autorizimeve dhe lejeve të nevojshme për koncesion;

b) të garantojë Koncesionarin se nuk do të lidhë asnjë marrëveshje tjetër, që mund të dëmtojë a pengojë prurjet ditore, stinore ose vjetore në hidrocentral;

c) të kontrollojë rregullisht ecurinë e kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në të;

ç) të garantojë blerjen e energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a., për 15 vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike, me çmimin sipas formulës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007;

d) të miratojë projektin e zbatimit të hidrocentralit. Koha e nevojshme për miratimin e projektit të zbatimit nuk bën pjesë në grafikun e punimeve të parashikuar në aneksin 2 bashkëlidhur.

Neni 6

Detyrimet e Koncesionarit

6.1 Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin e zbatimit në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë kontratë.

6.2 Koncesionari është i detyruar:

a) të formojë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate, shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj hartimin e projektzbatimit, ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të afatit të koncesionit. Shoqëria koncesionare do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri, si dhe në rast transferimi të kuotave të shoqërisë apo pjesëve të kapitalit të saj te të tretët, ajo duhet të marrë pëlqimin me shkrim të Autoritetit Kontraktues;

b) të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas aneksit bashkëlidhur kësaj kontrate;

c) të kryejë investimin sipas afateve të parashikuara në këtë kontratë dhe në cilësinë e kërkuar;

ç) të fillojë punën menjëherë pas miratimit të projektit të zbatimit sipas pikës “d” të nenit 5;

d) të menaxhojë e administrojë hidrocentralin gjatë periudhës së koncesionit;

dh) të përballojë shpenzimet që lidhen me dëmet që mund t'i shkaktohen palëve të treta për faj të vet;

e) të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ndikojë në zbatimin e Projektit të zbatimit;

ë) të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;

f) të marrë masa për të garantuar kushtet e sigurimit në punë për punëtorët dhe personat e tjerë, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private, si dhe të respektojë legjislacionin në lidhje me parandalimin e dëmeve a fatkeqësive në punë;

g) të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale;

h) të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit sipas grafikut të punimeve të parashikuar në aneksin bashkëlidhur;

i) Të zbatojë projektin e zbatimit për ndërtimin e hidrocentralit.

Neni 7
Vlera e investimeve

7.1 Vlera e investimeve, që duhet të kryhet nga Koncesionari (sipas aneksit 1), është në vlerën totale 2 355 000 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro, nga të cilat 852 500 (tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) euro do të investohen në makineri e pajisje.

7.2 Vlera e mësipërme mund të pësojë ndryshime me marrëveshje ndërmjet palëve:

a) pasi të jetë paraqitur projekti i zbatimit;

b) në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

7.3 Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 2 355 000 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro, por jo më e vogël se 2 237 250 (dy milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5% të investimit total të parashikuar.

Neni 8
Programi i punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm të punimeve:

8.1 Koncesionari merr përsipër të vendosë në punë hidrocentralin brenda 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit, por jo më vonë se 24 (njëzet e katër) muaj nga miratimi i kësaj kontrate.

8.2 Ky afat mund të ndryshojë me marrëveshje ndërmjet palëve, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse vonohet përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

Neni 9
Zgjidhja e kontratës së koncesionit

9.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate në mënyrë të njëanshme:

a) Kur Koncesionari nuk fillon punë brenda tetë muajve nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

b) në rast mosrealizimi të fuqisë së vendosur mbi 10% të asaj sipas projektzbatimit të propozuar nga Koncesionari;

c) kur Koncesionari transferon kuotat ose kapitalin pa marrë miratimin e Autoritetit Kontraktues.

9.2 Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë afatit të koncesionit ka shkelje të detyrimeve, kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë kontratë, Autoriteti njofton për këtë Koncesionarin, duke i kërkuar këtij të japë arsyet për shkeljen e konstatuar, brenda një periudhe prej 30 ditësh. Në rast se brenda këtij afati Koncesionari nuk përgjigjet, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta zgjidhë këtë kontratë.

9.3 Në rast se Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 9.1 e këtij neni), Autoriteti ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës. Autoriteti ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hidrocentralit, për sigurimin e një shërbimi efektiv dhe të pandërprerë dhe në rastin e dështimit të Koncesionarit të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës.

9.4 Secila Palë ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:

a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që dalin jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës Palë;

b) ka shkelje serioze nga njëra Palë, shkelje e cila nuk mund të korrigjohet brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë kontratë.

9.5 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë kontratë me pëlqim të dyanshëm.

Neni 10
Kontratat

10.1 Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje. Në lidhjen dhe nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes me nënkontraktorët, Koncesionari mban përsysh kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë kontratë.

10.2 Pavarësisht nga kontratat e sipërmarrjes, Koncesionari mbetet përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave të sipërmarrjeve. Me përjashtim të detyrimeve që ka sipas kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve.

10.3 Koncesionari nuk ka të drejtë t'ia kalojë a transferojë këtë kontratë një personi tjetër.

Neni 11

Garancitë

11.1 Koncesionari duhet të garantojë, për llogari të Autoritetit Kontraktues (sipas formularit të paraqitur në dokumentet e tenderit), para firmosjes së kontratës, një shumë të barabartë me 10% të vlerës totale të investimit prej 2 355 000 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro.

11.2 Koncesionarit i lejohet të çngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 ditëve nga realizimi i investimit dhe vënia në punë e të gjithë veprës.

Neni 12

Sigurimet

12.1 Koncesionari siguron hidrocentralin gjatë të gjithë afatit të koncesionit dhe një kopje të policës së sigurimit e depoziton çdo vit pranë Autoritetit Kontraktues.

12.2 Në rast se hidrocentrali shkatërrohet ose dëmtohet për shkaqet për të cilat ai është siguruar, zhdëmtimet financiare që vijnë nga siguracionet do të përdoren nga Koncesionari për të rindërtuar, riparuar dhe rikthyer hidrocentralin në gjendjen e mëparshme, përpara shkatërrimit ose dëmtimit.

12.3 Koncesionari duhet të sigurohet për përgjegjësitë, për dëmet materiale dhe fizike, që mund t'u shkaktohen palëve të treta, si rrjedhojë e punimeve të ndërtimit/montimit të hidrocentralit, si dhe gjatë shfrytëzimit të tij.

12.4 Sigurimi i objekteve do të kryhet për kufij të përgjegjësisë jo më të ulët se 200 000 (dyqind mijë) euro për çdo ngjarje, deri në 500 000 (pesëqind mijë) euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 (njëmijë) euro për çdo ngjarje dhe 2000 (dymijë) euro në vit.

12.5 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 13

Kontrolli, raportimi, inspektimet dhe mbikëqyrja e përgjithshme

13.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë Koncesionarin gjatë të gjithë afatit të koncesionit.

13.2 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që gjatë fazës së ndërtimit të hidrocentralit, të inspektojë dhe kontrollojë punimet, për të parë përmbushjen e kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë.

13.3 Koncesionari raporton me shkrim çdo muaj tek Autoriteti Kontraktues për realizimin e programit të punimeve (investimeve), në vlerë dhe në natyrë dhe pas fillimit të shfrytëzimit, çdo tre muaj për prodhimin e energjisë elektrike.

13.4 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të mbikëqyrë ecurinë e punimeve dhe cilësinë e kryerjes së tyre, nëse janë në përputhje me programin e punimeve dhe me dokumentacionin e projektit përfundimtar.

Neni 14

Tarifa koncesionare dhe vlera e investimit

14.1 Tarifa koncesionare është 2.1% e energjisë së prodhuar, të cilën Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta shesë për llogari të vet.

14.2 Vlera e riinvestimit është 50% e vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet. Kjo vlerë do të investohet, në dy këste çdo 15 vjet dhe do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 15

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 16

Forca madhore dhe të paparashikuara

16.1 Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta me akte me fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje tjetër e njëjtë, që mund të ndikojë në përmbushjen e kësaj kontrate, si dhe të detyrimeve reciproke që parashikohen në këtë kontratë dhe që nuk varen nga vullneti i Palëve ose që nuk kanë të bëjnë me vullnetin e tyre.

16.2 Në rast se verifikohen vonesa në realizimin e kësaj kontrate ose mospërmbushje të detyrimeve të Palëve, si pasojë e ngjarjeve të forcës madhore, vonesat ose mospërmbushjet nuk mund të shërbejnë si bazë për çdo palë për të kërkuar zhdëmtim nga pala tjetër.

16.3 Kur një detyrim i kësaj kontrate nuk do të zbatohet ose përmbushet si rezultat i forcës madhore, Pala e dëmtuar njofton me shkrim Palën tjetër brenda 30 ditëve, shtyrjen e afatit të punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe/ose masat që do të merren për kapërcimin e pasojave.

16.4 Afati i ndërprerjes së punimeve dhe shtyrja në kohë e tyre, do të përcaktohen nga Palët në një procesverbal, menjëherë pas ndodhjes së ngjarjes së forcës madhore.

Neni 17

Hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit

Kjo kontratë e nënshkruar nga Palët hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

18.1 Mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate, nuk pezullojnë ose anulojnë detyrimet e Palëve që burojnë nga kjo kontratë. Palët angazhohen ta zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre.

18.2 Kur një mosmarrëveshje nuk zgjidhet me mirëkuptim, Pala e interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e saj.

18.3 Paditë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve paraqiten në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 19

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të periudhës 15-mujore penalizon Koncesionarin si më poshtë:

a) për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05% në ditë të vlerës së investimeve të munguara;

b) për moskryerje të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurrim, Koncesionari penalizohet me 10% të vlerës së investimeve të parealizuara;

- c) për çdo ditë vonesë në fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë;
- ç) në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 16 milionësh KWh/vit, Koncesonari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të përealizuar për periudhën raportuese.
- d) për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të zbatimit, Koncesonari do të penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar;
- e) nëse mosrealizimi është më shumë se 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të zbatimit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të prishë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 20

Bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

20.1 Autoriteti Kontraktues dhe Koncesonari zotohen me vullnet të plotë të bashkëpunojnë për realizimin e plotë të kësaj kontrate.

20.2 Korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresat përkatëse.

20.3 Për çdo ndihmë që do t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, Koncesonari i paraqet Autoritetit kërkesë me shkrim.

Neni 21

Transferimi i aseteve

Me mbarimin e kësaj kontrate, qoftë si përfundim i afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e koncesionit, përfshirë çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesonari në kantierin e koncesionit, i transferohen Autoritetit Kontraktues, të lirë nga ndonjë detyrim, objekt i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate koncesionare. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën, por jo detyrimin, të ndërhyjë në çdo kontratë të Koncesionarit.

Neni 22

Regjistrimi i hidrocentralit

22.1 Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të Autoritetit Kontraktues.

22.2 Koncesonari ka të drejtë të vërë hidrocentralin si kolateral brenda periudhës së koncesionit.

22.3 Kjo kontratë bëhet në tetë kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilat e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan atë lirisht para meje, ndërsa unë noterja, e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

Autoriteti Kontraktues

Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Përfaqësuar me autorizimin nr.1828/7, datë

14.9.2007 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Nga z.Kristo Rodi

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme

Rregullatore

Koncesionari

Shoqëria "Xhemi 02"

Përfaqësuar nga Baftjar Xhaja

ANEKSI I

PREVENTIVI PARAPRAK

OBJEKTI : HEC- i Verbe – Selce

NR	EMERTIMI	NJESIA E MATJES	VLERA	NJESIA E MATJES	VLERA
1	PUNIME CIVILE	EURO	728945	LEKE	88 931 290
2	MAKINERI PAJISJE	EURO	852500	LEKE	104 005 000
3	IMPIANTI I TRANSFORMIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE DHE CELAT 10 KV	EURO	224045	LEKE	29 773 490
4	LINJA E TRANSMETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE	EURO	54000	LEKE	6 588 000
5	PAJISJET E KONTROLLIT DHE MONITORIMIT	EURO	33000	LEKE	4 026 000
6	PUNIME SHTESE	EURO	43000	LEKE	5 246 000
7	SHPENZIME TRANSPORTI DHE DOGANORE	EURO	38000	LEKE	4 636 000
8	KOSTO E PROJEKTIT	EURO	59510	LEKE	7 260 220
9	SHPENZIMET ADMINISTRATIVE	EURO	120000	LEKE	14 640 000
10	TRAJNIMI I SPECIALISTEVE	EURO	100000	LEKE	12 200 000
11	SHPENZIME PERSONELI	EURO	40000	LEKE	4 880 000
12	MJETE TRANSPORTI	EURO	42000	LEKE	2 684 000
	TOTALI (1 ÷12)	EURO	2335000	LEKE	284 870 000
	<i>Vlera e TVSH 20 %</i>	EURO	<i>467000</i>	<i>LEKE</i>	<i>56 974 000</i>
	TOTALI	EURO	2802000	LEKE	341 844 000

GRAFIKU I PUNIMEVE: HIDROCENTRALI VERBE-SELCE		1	3	6	9	12	15	ANEKSI 2	24	11	14	17	20	23	26	29	32	35	38	41	44	47	50	53	56	59	62	65	68	71	74	77	80	83	86	89	92	95	98	101	104	107	110	113	116	119	122	125	128	131	134	137	140	143	146	149	152	155	158	161	164	167	170	173	176	179	182	185	188	191	194	197	200	203	206	209	212	215	218	221	224	227	230	233	236	239	242	245	248	251	254	257	260	263	266	269	272	275	278	281	284	287	290	293	296	299	302	305	308	311	314	317	320	323	326	329	332	335	338	341	344	347	350	353	356	359	362	365	368	371	374	377	380	383	386	389	392	395	398	401	404	407	410	413	416	419	422	425	428	431	434	437	440	443	446	449	452	455	458	461	464	467	470	473	476	479	482	485	488	491	494	497	500	503	506	509	512	515	518	521	524	527	530	533	536	539	542	545	548	551	554	557	560	563	566	569	572	575	578	581	584	587	590	593	596	599	602	605	608	611	614	617	620	623	626	629	632	635	638	641	644	647	650	653	656	659	662	665	668	671	674	677	680	683	686	689	692	695	698	701	704	707	710	713	716	719	722	725	728	731	734	737	740	743	746	749	752	755	758	761	764	767	770	773	776	779	782	785	788	791	794	797	800	803	806	809	812	815	818	821	824	827	830	833	836	839	842	845	848	851	854	857	860	863	866	869	872	875	878	881	884	887	890	893	896	899	902	905	908	911	914	917	920	923	926	929	932	935	938	941	944	947	950	953	956	959	962	965	968	971	974	977	980	983	986	989	992	995	998	1001	1004	1007	1010	1013	1016	1019	1022	1025	1028	1031	1034	1037	1040	1043	1046	1049	1052	1055	1058	1061	1064	1067	1070	1073	1076	1079	1082	1085	1088	1091	1094	1097	1100	1103	1106	1109	1112	1115	1118	1121	1124	1127	1130	1133	1136	1139	1142	1145	1148	1151	1154	1157	1160	1163	1166	1169	1172	1175	1178	1181	1184	1187	1190	1193	1196	1199	1202	1205	1208	1211	1214	1217	1220	1223	1226	1229	1232	1235	1238	1241	1244	1247	1250	1253	1256	1259	1262	1265	1268	1271	1274	1277	1280	1283	1286	1289	1292	1295	1298	1301	1304	1307	1310	1313	1316	1319	1322	1325	1328	1331	1334	1337	1340	1343	1346	1349	1352	1355	1358	1361	1364	1367	1370	1373	1376	1379	1382	1385	1388	1391	1394	1397	1400	1403	1406	1409	1412	1415	1418	1421	1424	1427	1430	1433	1436	1439	1442	1445	1448	1451	1454	1457	1460	1463	1466	1469	1472	1475	1478	1481	1484	1487	1490	1493	1496	1499	1502	1505	1508	1511	1514	1517	1520	1523	1526	1529	1532	1535	1538	1541	1544	1547	1550	1553	1556	1559	1562	1565	1568	1571	1574	1577	1580	1583	1586	1589	1592	1595	1598	1601	1604	1607	1610	1613	1616	1619	1622	1625	1628	1631	1634	1637	1640	1643	1646	1649	1652	1655	1658	1661	1664	1667	1670	1673	1676	1679	1682	1685	1688	1691	1694	1697	1700	1703	1706	1709	1712	1715	1718	1721	1724	1727	1730	1733	1736	1739	1742	1745	1748	1751	1754	1757	1760	1763	1766	1769	1772	1775	1778	1781	1784	1787	1790	1793	1796	1799	1802	1805	1808	1811	1814	1817	1820	1823	1826	1829	1832	1835	1838	1841	1844	1847	1850	1853	1856	1859	1862	1865	1868	1871	1874	1877	1880	1883	1886	1889	1892	1895	1898	1901	1904	1907	1910	1913	1916	1919	1922	1925	1928	1931	1934	1937	1940	1943	1946	1949	1952	1955	1958	1961	1964	1967	1970	1973	1976	1979	1982	1985	1988	1991	1994	1997	2000	2003	2006	2009	2012	2015	2018	2021	2024	2027	2030	2033	2036	2039	2042	2045	2048	2051	2054	2057	2060	2063	2066	2069	2072	2075	2078	2081	2084	2087	2090	2093	2096	2099	2102	2105	2108	2111	2114	2117	2120	2123	2126	2129	2132	2135	2138	2141	2144	2147	2150	2153	2156	2159	2162	2165	2168	2171	2174	2177	2180	2183	2186	2189	2192	2195	2198	2201	2204	2207	2210	2213	2216	2219	2222	2225	2228	2231	2234	2237	2240	2243	2246	2249	2252	2255	2258	2261	2264	2267	2270	2273	2276	2279	2282	2285	2288	2291	2294	2297	2300	2303	2306	2309	2312	2315	2318	2321	2324	2327	2330	2333	2336	2339	2342	2345	2348	2351	2354	2357	2360	2363	2366	2369	2372	2375	2378	2381	2384	2387	2390	2393	2396	2399	2402	2405	2408	2411	2414	2417	2420	2423	2426	2429	2432	2435	2438	2441	2444	2447	2450	2453	2456	2459	2462	2465	2468	2471	2474	2477	2480	2483	2486	2489	2492	2495	2498	2501	2504	2507	2510	2513	2516	2519	2522	2525	2528	2531	2534	2537	2540	2543	2546	2549	2552	2555	2558	2561	2564	2567	2570	2573	2576	2579	2582	2585	2588	2591	2594	2597	2600	2603	2606	2609	2612	2615	2618	2621	2624	2627	2630	2633	2636	2639	2642	2645	2648	2651	2654	2657	2660	2663	2666	2669	2672	2675	2678	2681	2684	2687	2690	2693	2696	2699	2702	2705	2708	2711	2714	2717	2720	2723	2726	2729	2732	2735	2738	2741	2744	2747	2750	2753	2756	2759	2762	2765	2768	2771	2774	2777	2780	2783	2786	2789	2792	2795	2798	2801	2804	2807	2810	2813	2816	2819	2822	2825	2828	2831	2834	2837	2840	2843	2846	2849	2852	2855	2858	2861	2864	2867	2870	2873	2876	2879	2882	2885	2888	2891	2894	2897	2900	2903	2906	2909	2912	2915	2918	2921	2924	2927	2930	2933	2936	2939	2942	2945	2948	2951	2954	2957	2960	2963	2966	2969	2972	2975	2978	2981	2984	2987	2990	2993	2996	2999	3002	3005	3008	3011	3014	3017	3020	3023	3026	3029	3032	3035	3038	3041	3044	3047	3050	3053	3056	3059	3062	3065	3068	3071	3074	3077	3080	3083	3086	3089	3092	3095	3098	3101	3104	3107	3110	3113	3116	3119	3122	3125	3128	3131	3134	3137	3140	3143	3146	3149	3152	3155	3158	3161	3164	3167	3170	3173	3176	3179	3182	3185	3188	3191	3194	3197	3200	3203	3206	3209	3212	3215	3218	3221	3224	3227	3230	3233	3236	3239	3242	3245	3248	3251	3254	3257	3260	3263	3266	3269	3272	3275	3278	3281	3284	3287	3290	3293	3296	3299	3302	3305	3308	3311	3314	3317	3320	3323	3326	3329	3332	3335	3338	3341	3344	3347	3350	3353	3356	3359	3362	3365	3368	3371	3374	3377	3380	3383	3386	3389	3392	3395	3398	3401	3404	3407	3410	3413	3416	3419	3422	3425	3428	3431	3434	3437	3440	3443	3446	3449	3452	3455	3458	3461	3464	3467	3470	3473	3476	3479	3482	3485	3488	3491	3494	3497	3500	3503	3506	3509	3512	3515	3518	3521	3524	3527	3530	3533	3536	3539	3542	3545	3548	3551	3554	3557	3560	3563	3566	3569	3572	3575	3578	3581	3584	3587	3590	3593	3596	3599	3602	3605	3608	3611	3614	3617	3620	3623	3626	3629	3632	3635	3638	3641	3644	3647	3650	3653	3656	3659	3662	3665	3668	3671	3674	3677	3680	3683	3686	3689	3692	3695	3698	3701	3704	3707	3710	3713	3716	3719	3722	3725	3728	3731	3734	3737	3740	3743	3746	3749	3752	3755	3758	3761	3764	3767	3770	3773	3776	3779	3782	3785	3788	3791	3794	3797	3800	3803	3806	3809	3812	3815	3818	3821	3824	3827	3830	3833	3836	3839	3842	3845	3848	3851	3854	3857	3860	3863	3866	3869	3872	3875	3878	3881	3884	3887	3890	3893	3896	3899	3902	3905	3908	3911	3914	3917	3920	3923	3926	3929	3932	3935	3938	3941	3944	3947	3950	3953	3956	3959	3962	3965	3968	3971	3974	3977	3980	3983	3986	3989	3992	3995	3998	4001	4004	4007	4010	4013	4016	4019	4022	4025	4028	4031	4034	4037	4040	4043	4046	4049	4052	4055	4058	4061	4064	4067	4070	4073	4076	4079	4082	4085	4088	4091	4094	4097	4100	4103	4106	4109	4112	4115	4118	4121	4124	4127	4130	4133	4136	4139	4142	4145	4148	4151	4154	4157	4160	4163	4166	4169	4172	4175	4178	4181	4184	4187	4190	4193	4196	4199	4202	4205	4208	4211	421
---	--	---	---	---	---	----	----	----------	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	-----

VENDIM
Nr.886, datë 19.12.2007

**PËR KRIJIMIN, FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT
TË KUALIFIKIMIT, PËR CERTIFIKIMIN E AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË
SEKTORIN PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e komisionit të kualifikimit, si njësi përgjegjëse për kualifikimin dhe certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik, në varësi të Ministrit të Financave.
2. Komisioni i kualifikimit përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët propozohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit dhe miratohen nga Ministri i Financave, për një periudhë 2-vjeçare.
3. Përcaktimi i kriterëve dhe i kushteve, që duhet të përmbushin personat, kandidatë për anëtarë të komisionit të kualifikimit, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Financave.
4. Anëtarët e komisionit të kualifikimit, në mbledhjen e tyre të parë, zgjedhin kryetarin.
5. Komisioni i kualifikimit e zhvillon veprimtarinë sipas një kalendarit të përcaktuar prej tij dhe mbledhet jo më pak se tetë herë në vit.
6. Mbledhja e komisionit të kualifikimit thirret nga kryetari, jo më vonë se 5 ditë para mbledhjes, duke u njoftuar anëtarëve rendin e ditës, të shoqëruar me materialet përkatëse.
7. Në raste të veçanta, komisioni i kualifikimit mund të mbledhet me kërkesë të:
 - Ministrit të Financave;
 - Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit;
 - Të paktën tre anëtarëve të komisionit, brenda shtatë ditëve kalendarike, nga data e marrjes së kërkesës.
8. Në mbledhje shqyrtohen probleme dhe merren vendime për kualifikimin dhe programet e trajnimit, kurrikulat e programeve dhe evidencat e pjesëmarrjes në trajnime, në përputhje me rregulloren e miratuar nga Ministri i Financave, për organizimin e procesit të trajnimit, në kuadër të certifikimit të audituesve të brendshëm.
9. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit të kualifikimit është jo më pak se katër anëtarë, me të drejtë vote.
10. Kryetari dhe çdo anëtar i komisionit kanë të drejtën e një vote. Kryetari voton i fundit. Vendimi është i vlefshëm kur votojnë “pro”, jo më pak se tre anëtarë. Votimi është i hapur, me përjashtim të votimit për kryetarin dhe në asnjë rast, nuk lejohet abstenimi, ndërsa vota kundër argumentohet.
11. Mbledhja drejtohet nga kryetari i komisionit dhe në mungesë të tij, nga anëtari me moshë më të madhe.
12. Ministri i Financave liron nga detyra anëtarët e komisionit, nëse mungojnë në 5 mbledhje, pa shkaqe të arsyeshme, gjatë një periudhe 1-vjeçare.
13. Përfundimet e çdo mbledhjeje pasqyrohen në një memorandum, i cili i bëhet i ditur Ministrit të Financave dhe së bashku me procesverbalin e mbledhjes, depozitohen në protokollin e Ministrisë së Financave.
14. Rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Financave.
15. Sekretari i komisionit të kualifikimit caktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit dhe përzgjidhet ndër punonjësit e strukturës, që mbulon kualifikimin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit.
16. Pranë Ministrisë së Financave krijohet regjistri i audituesve të brendshëm në sektorin publik.
17. Kryetari, anëtarët dhe sekretari i komisionit të kualifikimit paguhën për çdo mbledhje, si më poshtë vijon:

- kryetari 6 000 lekë;
- anëtarët 5 000 lekë, secili;
- sekretari 3 000 lekë.

18. Të ardhurat, që realizohen nga procesi i kualifikimit dhe i certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

19. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga Buxheti i Shtetit, i miratuar për Ministrinë e Financave.

20. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

21. Të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.887, datë 19.12.2007

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË KULLOTAVE DHE LIVADHEVE SHTETËRORE PËR KULLOTJE DHE KOSITJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 1, e 17, pika 5 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.236, datë 6.6.1994 i Këshillit të Ministrave “Për tarifat e kullotjes në fondin kullor të kullotave e pyjeve në administrim të drejtorive të shërbimit pyjor e të kullotave dhe të komunave”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA

a) Tarifat e kullotjes së bagëtive:

Nr.	Lloji i bagëtive	Tipi i kullotës		Pyje që kulloten lekë/krerë
		Dimërore lekë/krerë	Verore lekë/krerë	
1.	Dhen	350	300	200
2.	Dhi	350	300	200
3.	Gjedh	1500	1300	1200
4.	Njëthundrak	1200	1000	800

b) Tarifat e kositjes së barit dhe krasitjes së drurëve pyjorë për gjethe:

Nr.	Emërtimi	Tipi i kullotës	Pyje që kulloten lekë/dru
-----	----------	-----------------	---------------------------

		Dimërore lekë/m ²	Verore lekë/m ²	
1	Kositje bari	x	1	10
2	Krasitje gjethi	x	x	10

c) Tarifat vjetore të përdorimit të sipërfaqes së tokës për ndërtimet provizore në fondin kullosor nga fermerët që mbarështojnë bagëti:

Nr.	Lloji i ndërtimit	Tipi i kullotës		Pyje që kulloten lekë/m ² /vit
		Dimërore lekë/m ² /vit	Verore lekë/m ² /vit	
1	Qendër stani e rrethuar	50	50	50
2	Qendër përpunim bulmeti	600	500	500
3	Ngrehinë banimi për barinj	400	200	200
4	Mullinj, magazina	300	300	300

VENDIM

Nr.888, datë 19.12.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE “PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË LODRAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave teknike “Për përcaktimin e kërkesave thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK

PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË LODRAVE

1. Ky rregull teknik zbatohet për lodrat. Lodër është çdo produkt apo material i projektuar ose i destinuar dukshëm për përdorim në lojë nga fëmijët nën moshën 14 vjeç.

2. Sipas këtij rregulli teknik, nuk konsiderohen lodra produktet e mëposhtme:

2.1 Zbukurimet për Krishtlindjet.

2.2 Modelet me shkallë të imta për koleksionistët e rritur.

2.3 Pajisjet e destinuara për përdorim kolektiv në sheshe lojërash.

2.4 Veglat sportive.

2.5 Pajisjet ujore të destinuara për përdorim brenda në ujë të thellë.

2.6 Kukulla popullore dhe kukulla zbukuruese apo artikuj të tjerë të ngjashëm, për koleksionistët e rritur.

2.7 Lodrat profesionale të instaluar në vende publike (qendra pazari, stacione etj.).

2.8 Lodra formuese, me më shumë se 500 copë formuese, ose pa pikturë, të destinuara për specialistë.

2.9 Pushkët ose pistoletat me ajër.

2.10 Fishekzjarret, përfshirë edhe kapsollat plasëse (me përjashtim të kapsulave plasëse të projektuara posaçërisht për përdorimin në lodra, pa paragjykuar dispozitat e rrepta shtrënguese që janë në fuqi).

2.11 Shilarësit dhe katapultat.

2.12 Komplete shigjetash me maja metalike.

2.13 Furra, hekura dhe produkte të tjera funksionale që punojnë me korrent në një voltazh minimal më shumë se 24 volt.

2.14 Produktet që përmbajnë elemente nxehëse, të destinuara për përdorim nën mbikëqyrjen e një të rrituri në një kuadër mësimdhënieje.

2.15 Automjetet me motor me djegie të brendshme.

2.16 Lodrat me motorë me avull.

2.17 B biçikletat e projektuara për sport ose për udhëtim në autostradë publike.

2.18 Videolodrat që mund të lidhen me një ekran videoje, i vënë në punë me një voltazh minimal më shumë se 24 volt.

2.19 Manekinë foshnjash.

2.20 Riprodhime besnike të armëve të vërteta të zjarrit.

2.21 Bizhuteritë e modës për fëmijë.

3. Lodra vendoset në treg, vetëm në rast se nuk rrezikon sigurinë dhe/ose shëndetin e përdoruesve apo palëve të treta, kur ajo përdoret siç është parashikuar, duke pasur parasysh sjelljen normale të fëmijëve.

4. Lodra, në kushtet në të cilat vendoset në treg, duhet të plotësojë kushtet e sigurisë dhe të shëndetit të parashikuara në këtë vendim, duke pasur parasysh periudhën e përdorimit normal të parashikuar.

5. Lodra duhet të plotësojë kërkesat thelbësore të sigurisë, si më poshtë:

5.1 Parime të përgjithshme

5.1 a) Në përputhje me kërkesat e pikës 3 të këtij rregulli teknik, përdoruesi i lodrës, si dhe palët e treta duhet të jenë të mbrojtura ndaj rreziqeve të shëndetit dhe dëmtimit fizik, kur lodra përdoret sipas destinimit ose në një mënyrë të parashikueshme, duke pasur parasysh sjelljen normale të fëmijëve. Rreziqe të tilla janë:

- ato që lidhen me projektimin, ndërtimin ose përbërjen e lodrës;

- ato që janë të qenësishme në përdorimin e lodrës dhe nuk mund të eliminohen plotësisht duke modifikuar ndërtimin dhe përbërjen pa ndryshuar funksionet e saj ose pa i zhveshur ato nga vetitë themelore.

5.1 b) Shkalla e rrezikut të pranishëm në përdorimin e lodrës duhet të jetë proporcionale me aftësinë e përdoruesve dhe, kur është e nevojshme, të mbikëqyrësve të tyre, për të përballuar atë. Kjo lidhet në veçanti me lodrën që, për shkak të funksioneve, përmasave dhe karakteristikave të saj, destinohet për përdorim nga fëmijët me moshë nën 36 muaj.

5.1 c) Për të zbatuar këtë parim, kur është e nevojshme, duhet të specifikohet një moshë minimale për përdoruesit e lodrës dhe/ose nevoja për të siguruar që ajo të përdoret vetëm nën mbikëqyrjen e të rriturve.

5.1 d) Etiketat mbi lodër dhe/ose mbi ambalazh, si dhe udhëzimet për përdorim që e shoqëron atë, duhet të tërheqin plotësisht dhe me efektivitet vëmendjen e përdoruesve dhe mbikëqyrësve të tyre ndaj rreziqeve që përfshihen në përdorimin e lodrës dhe ndaj mënyrave të shmangies së këtyre rreziqeve.

5.2 Rreziqe të veçanta

5.2.1 Vetitë fizike dhe mekanike

5.2.1 a) Lodra dhe pjesët e saj dhe, në rastin e lodrës së mbërthyer, ankorimet e tyre duhet të kenë forcën e duhur mekanike, dhe kur është e nevojshme, qëndrueshmërinë për t'i rezistuar shtypjeve të cilave iu nënshtrohen gjatë përdorimit, pa u thyer ose pa u shtrembëruar me rrezik shkaktimin e dëmtimeve fizike.

5.2.1 b) Buzët e prekshme, daljet jashtë sipërfaqes, kabllot, kordonët dhe perçinat/mjetet

mbërthyes mbi lodër, duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që rreziqet e dëmtimit fizik nga kontakti me to të ulen sa më shumë të jetë e mundur.

5.2.1 c) Lodra duhet të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që rreziqet e dëmtimit fizik, që mund të shkaktohen nga lëvizja e pjesëve të tyre, të mund të minimizohen.

5.2.1 d) Lodra, pjesët përbërëse të saj dhe çdo pjesë e shkëputshme e tyre që janë të destinuara për përdorimin e lodrës, e cila duket qartë se është planifikuar për përdorim nga fëmijët nën moshën 36 muaj, duhet të ketë përmasa të tilla që të parandalojnë gëlltitjen ose futjen në trup nëpërmjet frymëmarrjes.

5.2.1 e) Lodra, pjesët e saj dhe paketimi i tyre i vendosur për shitjen me pakicë, nuk duhet të paraqesë rrezikun e mbytjes ose të zënies së frymës së fëmijëve.

5.2.1 f) Lodra e destinuar për përdorim në ujëra të cekëta, e cila mund të mbajë ose tërheqë një fëmijë mbi ujë, duhet të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që, të zvogëlojë sa më shumë të jetë e mundur rrezikun e humbjes së lundrimit mbi ujë dhe të mbajtes mbi ujë që i ofrohet fëmijës, duke marrë parasysh rekomandimin për përdorimin e lodrës.

5.2.1 g) Lodra për të cilën është mundësia e hyrjes brenda saj dhe që, në këtë mënyrë, përbën një hapësirë të mbyllur për përdoruesin, duhet të ketë një mjet daljeje, që mund të hapet lehtësisht nga brenda.

5.2.1 h) Lodra që i përcjell lëvizje përdoruesit të saj duhet që sa më shumë që të jetë e mundur të ketë në përbërje një sistem frenimi që t'i përshtatet tipit të lodrës dhe të jetë në përputhje me energjinë kinetike të zhvilluar prej saj. Një sistem i tillë duhet të jetë lehtësisht i përdorshëm nga përdoruesi, pa rrezikun e hedhjes ose dëmtimit fizik të vetë atij, ose të palëve të treta.

5.2.1 i) Forma dhe përbërja e objekteve goditëse fluturuese, si dhe energjia kinetike që mund të zhvillohet kur flaken nga një lodër të projektuar për këtë qëllim, duhet të jenë të tilla që, duke marrë parasysh natyrën e lodrës, të mos ketë rrezik të paarsyeshëm për dëmtim fizik të përdoruesit ose palëve të treta.

5.2.1 j) Lodra që përmban elemente nxehjeje duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të sigurohet që:

- temperatura maksimale e sipërfaqeve të depërtueshme të jashtme të mos shkaktojë djegie kur preket;

- lëngjet dhe gazet brenda lodrës të mos arrijnë temperatura ose trysni të tilla që çlirimi i tyre nga lodra, përveç arsyeve themelore që kanë të bëjnë me funksionimin e duhur të lodrës, të mund të shkaktojnë djegie, përcëllime ose dëmtime të tjera fizike.

5.2.2 Djegshmëria

5.2.2 a) Lodra nuk duhet të përbëjë një element të djegshëm të rrezikshëm në ambientin e fëmijës. Për këtë qëllim, ajo duhet të përbëhet nga materiale që:

- nuk digjen me ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj flakës, shkëndijave ose një bartësi të mundshëm të zjarrit; ose

- nuk marrin flakë menjëherë (flaka shuhet sapo të zhduset shkaku i zjarrit); ose

- në rast se ndizen, të digjen ngadalë dhe të paraqesin një shkallë të ulët të përhapjes së zjarrit; ose

- pavarësisht nga përbërja kimike e lodrave, trajtohen në mënyrë të tillë që të vonojnë procesin e djegies.

Këto materiale të djegshme nuk duhet të përbëjnë rrezik ndezjeje për materiale të tjera të përdorura në lodër.

5.2.2 b) Lodra që, për arsye themelore të funksionimit të tyre, përmban lëndë ose preparate të rrezikshme, siç përkufizohen në ligjin nr.9108, datë 17.7.2003 “Për substancat e rrezikshme”, në veçanti materialet dhe pajisjet për eksperimente kimike, montime modeli, kallëpe plastike ose qeramike, emalim, fotografi ose veprimtari të ngjashme, nuk duhet të përmbajë substanca ose preparate që mund të bëhen të djegshme për shkak të humbjes së përbërësve fluororë të padjegshëm.

5.2.2 c) Lodra nuk duhet të jetë eksplozive ose të përmbajë elemente apo substanca që mund të shpërthejnë, kur përdoret siç është specifikuar në pikën 3. Kjo dispozitë nuk zbatohet për lodrën, kapsulë plasëse, për të cilën duhet të bëhet referencë me pikën 2.10 dhe shënimin përkatës.

5.2.2 d) Lodra dhe, në veçanti, lojërat dhe lodrat kimike, nuk duhet të përmbajnë lëndë ose

preparate të tilla që, kur përzihen mund të shpërthejnë:

- përmes reaksioneve kimike ose nxehjes;
- kur përzihen me lëndë oksiduese;

ose përmbajnë elemente përbërëse flurore që digjen në ajër dhe mund të formojnë përzierje ajër/avull të djegshme ose shpërthyes.

5.2.3 Vetitë kimike

5.2.3 a) Lodra duhet të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që, kur përdoret siç specifikohet në pikën 3 të rregullit teknik, ajo të mos paraqesë rreziqe për shëndetin ose rreziqe për dëmtim fizik përmes gëlltimit, frymëmarrjes ose kontaktit me lëkurën, me indet mukoze ose sytë.

Në të gjitha rastet ato duhet të përputhen me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë, që ka të bëjë me kategori të caktuara produktesh ose me ndalimin, kufizimin e përdorimit ose etiketimin e disa lëndëve dhe preparateve të rrezikshme.

5.2.3 b) Në veçanti, për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve, biodisponibiliteti që rrjedh nga përdorimi i lodrës, si objektiv nuk duhet t'i kalojë nivelet e mëposhtme në ditë:

- 0,2 µg për antimonin;
- 0,1 µg për arsenikun;
- 25,0 µg për bariumin;
- 0,6 µg për kadmiumin;
- 0,3 µg për kromin;
- 0,7 µg për plumbin;
- 0,5 µg për mërkurin;
- 5,0 µg për seleniumin;

ose vlera të tjera të tilla që mund të caktohen për këto lëndë ose të tjera në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë mbi bazën e provave shkencore.

Biodisponibiliteti i këtyre lëndëve do të thotë që ekstrakti i tretshëm ka rëndësi toksikologjike.

5.2.3 c) Lodra nuk duhet të përmbajë lëndë ose preparate të rrezikshme brenda kuptimit të ligjit nr.9107, datë 17.7.2003 "Për substancat e rrezikshme", në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e fëmijëve që i përdorin ato. Në të gjitha rastet, është rreptësisht e ndaluar që në një lodër të përfshihen lëndë ose preparate të rrezikshme në rast se ato destinohen të përdoren si të tilla gjatë përdorimit të lodrës.

Megjithatë kur një numër i kufizuar lëndësh ose preparatesh janë themelore për funksionimin e një lodre të caktuar, në veçanti, të materialeve dhe pajisjeve për eksperimente kimike, montim modeli, kallëpe plastike ose qeramike, emalim, fotografi ose veprimtari të tjera të ngjashme, ato lejohen deri në një nivel maksimal përqendrimi, me kusht që lëndët dhe preparatet e lejuara të jenë në konformitet me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.824, datë 11.12.2003 "Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe preparateve të rrezikshme" në lidhje me etiketimin, pa paragjykuar pikën 26(d).

5.2.4 Vetitë elektrike

5.2.4 a) Lodra elektrike nuk duhet të vihet në funksionim me energji elektrike me voltazh nominal mbi 24 volt dhe asnjë pjesë e lodrës nuk duhet t'i kalojë këto 24 volt.

5.2.4 b) Pjesët e lodrës që janë të lidhura, ose që mund të hyjnë në kontakt, me një burim energjie të aftë për të shkaktuar goditje elektrike, së bashku me kabllot ose përcjellësit e tjerë përmes të cilëve kalon energjia elektrike, duhet të izoloohen siç duhet dhe të mbrohen mekanikisht në mënyrë të tillë që të parandalojnë rrezikun e kësaj goditjeje.

5.2.4 c) Lodra elektrike duhet të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që të sigurojë që temperaturat maksimale që arrihen nga sipërfaqet drejtpërdrejt të jashtme të mos jenë të tilla që të shkaktojnë djegie kur preken.

5.2.5 Higjiena

Lodra duhet të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që të plotësojë kërkesat e higjienës dhe pastërtisë, me qëllim që të shmangët një rrezik infeksioni, sëmundjeje dhe ndotjeje.

5.2.6 Radioaktiviteti

Lodra nuk duhet të përmbajë elemente ose lëndë radioaktive në forma ose përpjesëtime që mund të dëmtojnë shëndetin e fëmijës. Në këtë rast zbatohet ligji nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese".

6. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, krijuar sipas ligjit për sigurinë e

përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore, prezumon që lodra që mban markën “CE”, të parashikuar në pikën 21, është në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij/saj rregulli teknik duke përfshirë dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të parashikuara në pikat 10, 11, 12, 13, 14. Lodra prezumohet se është në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 5, kur është në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare, referenca e të cilave është botuar në Fletoren Zyrtare.

7. Kur fabrikuesi nuk i ka zbatuar standardet e harmonizuara shqiptare të lodrave, ose i ka zbatuar ato pjesërisht, ose për lodrat për të cilat nuk ekzistojnë standarde të tilla, lodra prezumohet se përmbush kërkesat thelbësore, të përcaktuara në pikën 5, kur pas marrjes së certifikatës të ekzaminimit të prototipit, konformiteti i saj me modelin e miratuar është certifikuar me vendosjen e markës “CE”.

8. Kur lodra është subjekt i rregullave teknike të tjera të miratuara nga Këshilli i Ministrave, që mbulojnë aspekte të tjera dhe që parashikojnë gjithashtu vendosjen e markës “CE”, kjo e fundit tregon që edhe lodra në fjalë prezumohet se është në përputhje edhe me dispozitat e këtyre rregullave teknike të tjera.

9. Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut vërteton se megjithëse lodra mban markën “CE”, ajo mund të rrezikojë sigurinë dhe/ose shëndetin e konsumatorëve dhe/ose palëve të treta, merr të gjitha masat për të vendosur kufizime për bërjen të disponueshme të lodrës në treg ose kërkon pezullimin apo tërheqjen e saj nga tregu. Menjëherë struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut njofton Ministrinë për këto masa, duke treguar arsyet për vendimin e saj dhe në veçanti, nëse moskonformiteti është pasojë:

a) e mosplotësisht të kërkesave thelbësore të përmendura në pikën 5, kur lodra nuk përputhet plotësisht me standardet e harmonizuara shqiptare;

b) e zbatimit jo të rregullt të këtyre standardeve;

c) e të metave të vetë standardeve të harmonizuara shqiptare.

10. Para vendosjes në treg, lodra e prodhuar në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare, duhet të ketë të vendosur markën “CE” me të cilën fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, konfirmon se lodra është në përputhje me këto standarde.

11. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, mbajnë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut informacionin e mëposhtëm:

- një përshkrim të lodrës (për shembull, përdorimin e një raporti të provave ose një dosje teknike), me anën e të cilave fabrikuesi siguron përputhshmërinë e produktit me standardet e harmonizuara shqiptare, dhe sipas nevojës:

- një certifikatë tip, të lëshuar nga një organ i autorizuar;

- kopjet e dokumenteve që ka paraqitur te organi i autorizuar;

- një përshkrim të metodave me anën e të cilave fabrikuesi siguron konformitetin me modelin e miratuar;

- adresën e fabrikës dhe të magazinës;

- informacion të hollësishëm lidhur me projektimin dhe prodhimin.

Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i autorizuar prej tij nuk janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, detyrimi i mësipërm për mbajtjen e një dosjeje në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut është përgjegjësi e personit që vendos lodrën në tregun shqiptar.

12. Lodra që nuk është plotësisht ose pjesërisht në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare, duhet që para vendosjes në treg të ketë vendosur markën “CE” me të cilën fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, konfirmon se lodra në fjalë është në përputhje me prototipin e ekzaminuar, sipas procedurave të përcaktuara në pikat 16, 17, 18, 19 dhe 20 nga një organ i autorizuar që ka përcaktuar se lodra plotëson kërkesat thelbësore të përmendura në pikën 5.

13. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, mban në dispozicion këtë informacion për kontroll:

- një përshkrim të hollësishëm të fabrikuesit;

- një përshkrim të mjeteve (si për shembull, përdorimin e raportit të provave ose një dosje teknike), me anën e të cilave fabrikuesi siguron konformitetin e prodhimit me modelin e miratuar;

- adresat e fabrikave dhe të magazinave;

- kopje të dokumenteve që fabrikuesi i ka paraqitur organit të autorizuar në përputhje me pikën

17;

- certifikatën e provës për mostrën ose një kopje të vërtetuar të saj.

14. Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i autorizuar prej tij nuk janë vendosur në Republikën e Shqipërisë, detyrimi i mësipërm për mbajtjen e dosjes teknike në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut është përgjegjësi e personit që hedh lodrën në tregun shqiptar.

15. Në rast moszbatimi në mënyrë të dukshme të detyrimeve të përcaktuara në pikat 11 dhe 13, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut i kërkon, në veçanti fabrikuesit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij, të kryejë me shpenzimet e tij brenda një periudhe të përcaktuar, një provë nga një organ i autorizuar, me qëllim që të verifikojë përputhjen e lodrës me standardet e harmonizuara dhe kërkesat thelbësore të pikës 5.

16. “Eksaminimi i prototipit” është procedura me anën e së cilës një organ i autorizuar vërteton dhe certifikon që një model lodre i plotëson kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 5.

Kriteret minimale për organet e autorizuar janë, si më poshtë:

16.1 Personel të disponueshëm dhe mjetet e pajisjet e nevojshme.

16.2 Kompetencë teknike dhe integritet profesional të personelit.

16.3 Pavarësi në kryerjen e testeve, përgatitjen e raporteve, lëshimin e certifikatave dhe kryerjen e mbikëqyrjes të parashikuara në këtë rregull teknik, të stafit dhe personelit teknik në lidhje me të gjitha grupet, ose personat e interesuar drejtpërdrejt ose indirekt për lodrat.

16.4 Besueshmëri në lidhje me ruajtjen e fshehtësisë profesionale.

16.5 Nënshkrimi i sigurimit të kontratës së përgjegjësisë civile, duke iu referuar kërkesave për organin e autorizuar, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

17. Aplikimi për ekzaminimin e prototipit bëhet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij.

Aplikimi do të përmbajë:

- përshkrimin e lodrës;

- emrin dhe adresën e fabrikuesit ose të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të autorizuar, si dhe vendin e prodhimit të lodrës;

- të dhëna të plota për projektimin dhe prodhimin të shoqëruar me një model të lodrës që do të prodhohet.

18. Organi i autorizuar kryen ekzaminimin e prototipit në mënyrën e përshkruar, më poshtë:

- ai shqyrton dokumentacionin e dhënë nga aplikuesi dhe përcakton nëse është i rregullt;

- kontrollon nëse lodra e rrezikon sigurinë dhe/ose shëndetin, siç parashikohet në pikën 2;

- kryen ekzaminimet e duhura dhe provat e nevojshme duke përdorur sa më shumë që të jetë e mundur standardet e harmonizuara shqiptare;

- për të kontrolluar nëse modeli i plotëson kërkesat thelbësore të përmendura në pikën 5, ai mund të kërkojë mostra të tjerë të modelit.


19. Kur modeli i plotëson kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 5, organi i autorizuar i lëshon aplikuesit një certifikatë të ekzaminimit të prototipit. Certifikata përmban kushtet nën të cilat certifikata është e vlefshme, përfundimet e kontrollit, dhe shoqërohet me përshkrimet dhe skicat e lodrës së miratuar.

Organet e autorizuar të tjera mund të sigurojnë me kërkesë një kopje të certifikatës dhe duke bërë kërkesë të arsyetuar, një kopje e programit të projektimit dhe prodhimit, si dhe raportet e ekzaminimeve dhe të provave të kryera.

20. Një organ i autorizuar që nuk pranon të lëshojë certifikatën e ekzaminimit të prototipit, informon për këtë ministrinë, duke dhënë arsyet për mospranimin.

21. Marka “CE”, emri dhe/ose emri tregtar dhe/ose marka dhe adresa e fabrikuesit ose përfaqësuesit e autorizuar prej tij, ose e importuesit të lodrës, bashkëngjitet mbi lodrën ose në ambalazh në formë të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe që nuk mund të fshihet. Në rastin e lodrave të vogla ose të lodrave që përbëhen nga pjesë të vogla, këto të dhëna mund të bashkëngjiten në të njëjtën mënyrë mbi ambalazh, mbi një etiketë ose manualin e udhëzimeve. Në të tilla raste, tërhiqet vëmendja e konsumatorëve për ruajtjen e tyre.

22. Marka e konformitetit “CE”, përbëhet nga inicialet “CE”, me formën sipas modelit të mëposhtëm:



- Në rast se marka “CE” zvogëlohet ose zmadhohet, përmasat e dhëna në vizatimin e shkallëzuar më lart duhet të respektohen.

- Përbërësit e ndryshueshëm të markës “CE” duhet të kenë ekzaktësisht të njëjtën përmasë vertikale, që nuk mund të jetë më pak se 5 mm.

23. Ndalohet vendosja në lodër e markave ose mbishkrimeve, të cilat shkaktojnë keqkuptime në treg dhe çorientojnë konsumatorin në drejtim të kuptimit dhe të formës së markës “CE”. Në lodër, ambalazhin apo etiketën e saj mund të vendoset çdo shënim tjetër me kusht që të mos cenojë pamjen dhe leximin e markës “CE”.

24. Të dhënat e përmendura në pikën 21 mund të shkurtohen me kusht që ky shkurtime t’i japë mundësinë fabrikuesit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij, dhe importuesit, të jenë të identifikueshëm.

25. Lodra duhet të shoqërohet me paralajmërime të përshtatshme, të lexueshme qartë, me qëllim reduktimin e rreziqeve të qenësishme në përdorimin e saj, siç janë të përshkruara në kërkesat thelbësore. Paralajmërimet ose masat përkatëse paraprake që duhet të merren parasysh në përdorimin e lodrave të mëposhtme, së bashku me informacionin e specifikuar në pikën 21, të jepen në gjuhën shqipe.

25 a) Lodrat që nuk janë të destinuara për fëmijë nën 36 muaj.

Lodra që mund të jetë e rrezikshme për fëmijët nën 36 muajsh duhet të ketë një paralajmërim, për shembull: “Jo e përshtatshme për fëmijët nën 36 muajsh”, ose “Jo e përshtatshme për fëmijën nën 3 vjeç”, si dhe në tregues të shkurtër, i cili mund të dalë edhe në udhëzimet e përdorimit, mbi rreziqet që detyrojnë këtë kufizim.

Kjo dispozitë nuk është e vlefshme për lodrën që, për shkak të funksionimit, përmasave, karakteristikave, vetive të saj ose shkaqeve të tjera të forta, që tregojnë se lodra është e papërshtatshme për fëmijët nën 36 muaj.

25 b) Patinat, shilarësit dhe unazat e pavarura, trapezat, litarët dhe lodra të ngjashme që lidhen me traversë.

Këto lodra shoqërohen me udhëzime që tërheqin vëmendjen në nevojën për të kryer kontrole dhe nevojën e mirëmbajtjes së pjesëve kryesore (suspensioneve, mbërthimeve, ankorimeve etj.), në intervale, dhe nevojën për të treguar që, në rast se këto kontrole nuk kryhen, lodra mund të shkaktojë një rrëzim ose shembje përmbys.

Duhet të jepen udhëzime edhe për montimin e duhur të lodrës, duke treguar ato pjesë që mund të paraqesin rreziqe në rast se nuk montohen siç duhet.

25 c) Lodrat funksionale

Lodra funksionale ose ambalazhimet e saj duhet të mbajnë shënimin: “Kujdes! Të përdoret nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një të rrituri”.

Krahas kësaj, kjo lodër duhet të shoqërohet me orientime që japin udhëzime funksionimi, si dhe masat paraprake që duhet të merren nga përdoruesi, me paralajmërimin që mosmarrja e këtyre masave paraprake do ta vinte përdoruesin përballë rreziqesh që specifikohen normalisht të lidhura me aparatit ose produktin imitim ose maket model i të cilit është lodra. Gjithashtu, duhet të tregohet që

lodra duhet të mbahet larg fëmijëve shumë të vegjël.

“Lodra funksionale” do të thotë lodra që përdoret në të njëjtën mënyrë me aparatet ose instalimet e synuara për të rriturit, dhe shpesh janë maket model i tyre.

25 d) Lodra që përmban lëndë ose preparate qenësisht të rrezikshme. Lodra kimike.

- Pa paragjykuar zbatimin e dispozitave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.824, datë 11.12.2003 “Mbi klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin dhe ruajtjen e substancave ose preparateve të rrezikshme”, udhëzimet për përdorimin e lodrave që përmbajnë lëndë ose preparate qenësisht të rrezikshme, duhet të përmbajnë një paralajmërim për natyrën e rrezikut të këtyre lëndëve ose preparateve, dhe një tregues të masave paraprake të specifikuara saktësisht sipas tipit të lodrës që duhet të merren nga përdoruesi, me qëllim që të shmangen rreziqet që e shoqërojnë. Duhet të përmendet edhe ndihma e parë që duhet të jepet në rast aksidentesh të rënda si rezultat i përdorimit të kësaj lodre. Duhet të theksohet gjithashtu që lodrat të mbahen larg fëmijëve shumë të vegjël.

- Krahas udhëzimeve të parashikuara në (a), lodrat kimike duhet të mbajnë në ambalazhin e tyre këtë shënim:

“Kujdes! Vetëm për fëmijët mbi (mosha vendoset nga prodhuesi) vjeç. Për përdorim nën mbikëqyrjen e të rriturve”.

Në veçanti, këto lodra konsiderohen si lodra kimike: komplete kimike, komplete plastike, reparte miniature për punim qeramike, emalim, fotografi dhe lodra të ngjashme.

25 e) Skitë dhe pllakat e skive për fëmijët.

Në rast se këto produkte ofrohen për shitje si lodra, ata mbajnë shënimin:

“Kujdes! Duhet të vishen pajime mbrojtëse”.

Për më tepër udhëzimet e përdorimit përmbajnë një kujtesë që lodra duhet të përdoret me kujdes, pasi ajo kërkon aftësi të madhe, me qëllim që të shmangen rrëzimet ose përplasjet që shkaktojnë dëmtim të përdoruesit dhe të palëve të treta.

Duhet të jepet tregues për pajimet mbrojtëse të rekomanduara (helmeta, dorashka, gjunjëza, mbrojtëse bërrylash etj.).

25 f) Lodra e destinuar për përdorim në ujë

Lodrat e destinuar për përdorim në ujë, të përkufizuara në pikën 5.2.1(f), përmbajnë paralajmërimin në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare:

“Kujdes! Për përdorim vetëm në ujë në thellësinë e duhur për fëmijën dhe nën mbikëqyrje”.

VENDIM

Nr.889, datë 19.12.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE “PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË ENËVE TË THJESHTA NËN PRESION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave teknike “Për përcaktimin e kërkesave thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të enëve të thjeshta nën presion”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT
TË ENËVE TË THJESHTA NËN PRESION

1. Ky rregull teknik zbatohet për enë të thjeshta nën presion, të prodhuara në seri.
2. Sipas këtij rregulli teknik termat e mëposhtëm kuptohen:
 - a) Enë e thjeshtë nën presion (më poshtë ena), është çdo enë e salduar që i nënshtrohet një presioni të brendshëm manometrik më të madh se 0.5 bar, që është e përcaktuar të mbajë ajër ose azot dhe nuk është e përcaktuar t'i ekspozohet flakës.
 - b) Prodhim në seri, konsiderohet rasti, kur më shumë se një enë e të njëjtit tip prodhohen gjatë një periudhe të caktuar kohe, nëpërmjet një procesi të pandërprerë prodhimi, sipas një projekti të përbashkët dhe duke përdorur të njëjtin proces prodhimi.
 - c) Një parti e enëve përbëhet më e shumta nga 3000 enë me model të të njëjtit tip.
 - d) Presioni i projektimit "P", është presioni manometrik i zgjedhur nga fabrikuesi dhe i përdorur për të përcaktuar trashësinë e pjesëve nën presion.
 - e) Presioni maksimal i punës "PS" është presioni manometrik maksimal, i cili mund të shfaqet në kushte normale të përdorimit.
 - f) Temperatura minimale e punës "Tmin", është temperatura më e ulët e stabilizuar në paretin e enës në kushte normale të përdorimit.
 - g) Temperatura maksimale e punës "Tmax", është temperatura më e lartë e stabilizuar, që mund të arrihet në paretin e enës në kushte normale të përdorimit.
 - h) Kufiri i elasticitetit R_{ET} është vlera në temperaturën maksimale të punës Tmax:
 - i) e kufirit të sipërm të rrjedhshmërisë ReH për një material me kufij të poshtëm e të sipërm;
 - ii) ose e tensionit të provës $R_p 0.2$;
 - iii) e tensionit të provës $R_p 1,0$ në rastin e aluminit të palidhur.
 - i) Familjet e enëve: Enët janë pjesë të së njëjtës familje, nëse ato ndryshojnë nga prototipi vetëm në diametër, me kusht që të plotësohen kërkesat e pranueshme të pikës 6.2.1.1 ose 6.2.1.2 dhe/ose në gjatësinë e pjesës së tyre cilindrike brenda kufirit të mëposhtëm:
 - i) kur prototipi ka një ose më shumë unaza të cilindrit, përveç pjesëve fundore, variantet e kësaj familjeje duhet të kenë së paku një unazë;
 - ii) kur prototipi ka vetëm dy pjesë fundore konkave, variantet në familje nuk duhet të kenë unaza të cilindrit;
 - iii) ndryshimet në gjatësi që sjellin hapje dhe/ose depërtime për t'u modifikuar paraqiten në vizatimet e secilit variant.
 - j) Fletë inspektimi: Dokumenti me anë të të cilit prodhuesi certifikon që produktet e dorëzuara plotësojnë kërkesat e porosisë dhe, në të cilën ai ekspozon rezultatet e testeve të zakonshme të inspektimit në fabrikë, në mënyrë të veçantë përbërjen kimike dhe karakteristikat mekanike. Këto teste kryhen mbi produktet e prodhuara me të njëjtin proces prodhimi, të furnizimit, por jo detyrimisht mbi produktet e dorëzuara.

k) Simbolet:

)	A	Zgjatimi mbas këputjes ($L_0=5,65S_0$)	%
	A 80 mm	Zgjatimi mbas këputjes ($L_0 = 80 \text{ mm}$)	%
i)	KCV	Energjia e këputjes	J/cm^2
ii)	P	Presioni i projektimit	bar
v)	PS	Presioni i punës	bar
)	P_h	Presioni i testit hidrostatik ose pneumatik	bar
i)	$R_p 0,2$	Tensioni i provës në 0,2 %	N/mm^2

ii)	R_{ET}	Fortësia e këputjes në temperaturën maksimale të punës	N/mm^2
iii)	R_{eH}	Pika e sipërme e këputjes	N/mm^2
x)	R_m	Rezistenca në këputje	N/mm^2
)	T_{max}	Temperatura maksimale e punës	$^{\circ}C$
i)	T_{min}	Temperatura minimale e punës	$^{\circ}C$
ii)	V	Vëllimi i enës	L
iii)	$R_{m\ max}$	Rezistenca maksimale në këputje	N/mm^2
iv)	$R_{p\ 1,0}$	Tension i provës në 1,0 %	N/mm^2
v)			

3. Enët kanë karakteristikat e mëposhtme:

a) Pjesët dhe bashkimet që ndihmojnë në forcimin e enës nën presion prodhohen prej çeliqueve cilësor jo të lidhur; prej aluminit jo të lidhur, si dhe prej lidhjeve të aluminit jo të vjetruar.

b) Ena përbëhet prej:

i) nga pjesa cilindrike e prerjes rrethore e mbyllur nga ana e jashtme, ose/dhe nga pjesët e sheshta fundore, të cilat kanë të njëjtin aks rrotullimi me pjesën cilindrike;

ii) ose nga pjesët fundore konkave, të cilat kanë të njëjtin aks rrotullimi.

c) Presioni maksimal i punës së enës nuk duhet të kalojë 30 bar dhe prodhimi i këtij presioni me vëllimin e enës (PS.V) nuk duhet të kalojë 10 000 bar L.

d) Temperatura minimale e punës nuk duhet të jetë më e ulët se $-50^{\circ}C$ dhe temperatura maksimale e punës nuk duhet të jetë më e lartë se $300^{\circ}C$ për çelikut dhe $100^{\circ}C$ për aluminin ose lidhje alumini.

4. Përrjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij rregulli teknik enët e mëposhtme:

a) enët specifikuara të projektuara për përdorim bërthamor, dëmtimi i të cilave mund të shkaktojë përhapjen e radioaktivitetit;

b) enët specifikuara të parashikuara për instalimin në anije dhe avione ose si shtytëse në to;

c) shuajtëset e zjarrit.

5. Dispozitat e këtij rregulli teknik, nuk prekin akte të tjera ligjore dhe nënligjore, që garantojnë mbrojtjen e punonjësve kur përdorin enët. Kjo nuk nënkupton që ena të modifikohet në mënyrë të pa përcaktuar në këtë rregull teknik.

6. Ena, në të cilën prodhimi i PS me V i kalon 50 bar L, duhet të plotësojë kërkesat thelbësore të përcaktuara si më poshtë:

6.1 Materialet

Materialet zgjidhen në përshtatje me përdorimin përcaktuar të enëve dhe në përputhje me pikat 6.1.1 deri 6.1.4.

6.1.1 Pjesët nën presion

a) Materialet, sipas pikës 1 të përdorura për prodhimin e pjesëve nën presion, duhet të jenë:

i) të përshtatshme për t'u salduar;

ii) rezistent dhe plastik (të epshëm), në mënyrë që një çarje ose një krisje në një temperaturë minimale të punës të mos çojë në copëzimin ose në frakturat e tipit thyerje;

iii) të mos pësojnë efekte të kundërt nga vjetrimi.

b) Materialet e enëve të çelikut duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në paragrafin 6.1.1.1 dhe të enëve prej alumin ose lidhjet e aluminit ato të përcaktuara në pikën 6.1.1.2.

c) Ato shoqërohen me një fletë inspektimi të hartuar nga prodhuesi i materialeve siç përshkruhet në pikën 28.

6.1.1.1 Enët e çelikut

Çeliquet e palidhur duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) duhet të jenë jo flluskues dhe të bëhen të disponueshëm pas një trajtimi normalizues ose të një gjendjeje ekuivalente;

b) përmbajtja në produkt e karbonit duhet të jetë më e vogël se 0.25 % dhe ajo e sulfurit dhe e fosforit duhet të jenë më pak se 0.05% secila;

c) të kenë vetitë mekanike të mëposhtme:

i) rezistenca maksimale në këputje $R_{m\max}$ duhet të jetë më pak sa 580 N/mm²;

ii) zgjatimi mbas këputjes të jetë:

- në qoftë se kampionet për testim marren paralelisht me drejtimin e petëzimit:

trashësia ≥ 3 mm; $A \geq 22\%$

trashësia < 3 mm; $A_{80\text{mm}} \geq 17\%$

- nëse kampionet janë marrë vertikalisht me drejtimin e petëzimit:

trashësia ≥ 3 mm $A \geq 20\%$

trashësia < 3 mm $A_{80\text{mm}} \geq 15\%$

iii) vlera mesatare e energjisë së këputjes KCV për tri kampione në drejtimin gjatësor dhe në temperaturën minimale të punës nuk duhet të jetë më pak se 35 J/cm². Vetëm njëra nga të tri vlerat mund të jetë më e vogël se 35 J/cm², por jo më pak se 25 J/cm²;

iv) në rastin e çeliqueve që përdoren për prodhimin e enëve, në të cilat temperatura minimale e punës është më ulët se -10 °C dhe trashësia e mureve i kalon 5 mm, kjo veti duhet të kontrollohet.

6.1.1.2 Enët e aluminit

Alumini jo i lidhur duhet të ketë përmbajtje alumini jo më pak se 99.5 %, ndërsa lidhjet e përcaktuara në pikën 2(a) të këtij rregulli teknik, duhet të paraqesin rezistencën e mjaftueshme për korrozionin ndërkristalin në temperaturën maksimale të punës.

Për më tepër, këto materiale duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të jepen në gjendje të kalitur; dhe

b) të kenë karakteristikat e mëposhtme mekanike për produkt:

i) rezistenca maksimale në këputje, $R_{m\max}$, të jetë jo më shumë se 350 N/mm²,

ii) zgjatimi mbas këputjes duhet të jetë:

$A \geq 16\%$, kur kampioni është marrë paralel me drejtimin e petëzimit;

$A \geq 14\%$, kur kampioni është marrë vertikalisht me drejtimin e petëzimit.

6.1.2 Materialet e saldimit

Materialet e saldimit që përdoren për kryerjen e saldimeve mbi ose në enë, të jenë të përshtatshme dhe të pajtueshme me materialet që saldohen.

6.1.3 Pajisjet shtesë (aksesorët) që ndikojnë në fortësinë e enës

Këto pajisje (p.sh. bulona dhe dado) duhet të jenë prej një materiali të specifikuar në pikën 6.1.1 ose nga lloje të tjera çeliku, alumini apo një lidhje e përshtatshme alumini e pajtueshme me materialet e përdorura për prodhimin e pjesëve nën presion. Këto të fundit, duhet të kenë një zgjatim mbas thyerjes dhe qëndrueshmëri të përshtatshme në temperaturën minimale të punës.

6.1.4 Pjesët që nuk i nënshtrohen presionit

Të gjitha pjesët që nuk i nënshtrohen presionit, të enëve të salduara të jenë nga materiale të pajtueshme me ato komponentë me të cilat saldohen.

6.2 Projektimi i enës

a) Fabrikuesi kur projekton enën përcakton përdorimin që do të ketë ajo dhe zgjedh:

i) temperaturën minimale të punës $T_{\min}$;

ii) temperaturën maksimale të punës $T_{\max}$;

iii) presionin maksimal të punës PS.

Në rast se zgjidhet temperatura minimale e punës që i kalon -10°C, cilësitë e kërkuara për materialet duhet të jenë të pranueshme për këtë temperaturë.

b) Fabrikuesi duhet gjithashtu të ketë parasysh kërkesat e mëposhtme:

i) të bëhet e mundur inspektimi i pjesës së brendshme të enës;

ii) të bëhet e mundur zbrazja e enëve;

iii) vetitë mekanike duhet të mbeten të pandryshuara gjatë gjithë periudhës së përdorimit të enës në përputhje me qëllimin e parashikuar;

iv) enët duhet të mbrohen në mënyrën e duhur nga korrozioni, duke pasur parasysh mënyrën e përdorimit në kushtet e parashikuara;

v) enët nuk duhet t'i nënshtrohen tensioneve të tilla që mund të dëmtojnë sigurinë e tyre në përdorim;

vi) presioni i brendshëm asnjëherë nuk duhet të kalojë presionin maksimal të punës PS, momentalisht mund ta kalojë këtë vlerë deri në 10%.

c) Tegelat e saldimit rrethorë e gjatësorë bëhen duke përdorur saldime të plota në thellësi ose saldime të cilat japin të njëjtin rezultat. Fundet konveks ndryshe nga ato gjysmësferike duhet të kenë tehe cilindrike.

6.2.1 Trashësia e pareteve

Në rast se prodhimi PS.V nuk është më i madh se 3000 bar L, fabrikuesi zgjedh një nga metodat e përshkruara në pikat 6.2.1(a) dhe (b) për përcaktimin e trashësisë së pareteve të enës; në se prodhimi i PS.V është më i madh se 3000 bar L ose nëse temperatura maksimale e punës i kalon 100°C, kjo trashësi do të përcaktohet nga metoda e përshkruar në (a). Trashësia faktike e seksionit cilindrik dhe e pjesëve fundore, nuk duhet të jetë më e vogël se 2 mm në rastin e enëve prej çeliku dhe jo më e vogël se 3mm në rastin e enëve prej alumini, ose alumini të lidhur.

a) Metoda e llogaritjeve

i) Trashësia minimale e pjesëve nën presion duhet të llogaritet duke mbajtur parasysh madhësinë e tensioneve, si dhe kërkesat e mëposhtme:

presioni i llogaritjes që merret në konsideratë duhet të jetë më i vogël se presioni i zgjedhur maksimal i punës;

tensioni i përgjithshëm i lejuar i membranës nuk duhet të kalojë vlerat $0,6 R_{ET}$ ose $0,3 R_m$. Fabrikuesi duhet të përdorë vlerat minimale të R_{ET} dhe R_m të garantuara nga prodhuesi i materialit, për të përcaktuar tensionin e lejuar.

ii) Nëse pjesa cilindrike e enës ka një ose më shumë tegela saldimi gjatësor, të salduar me proces saldimi joautomatik, trashësia e llogaritur si më sipër duhet të shumëzohet me koeficientin 1,15.

b) Metoda eksperimentale

Trashësia e mureve/pareteve përcaktohet në atë mënyrë që të bëjë të mundur që ena të rezistojë në temperaturën e ambientit në një presion të paktën 5 herë më shumë se presioni maksimal i punës, me një vlerë të faktorit të deformimit periferik të përhershëm jo më të madh se 1%.

6.3 Procesi i prodhimit

Enët konstruktohen dhe i nënshtrohen kontrolleve të prodhimit në përputhje me dokumentacionin teknik të projektit dhe të prodhimit të përcaktuar në pikën 28.

6.3.1 Përgatitja e pjesëve përbërëse

Përgatitja e pjesëve përbërëse (p.sh. formimi dhe prerja) nuk duhet të shkaktojë lindjen e defekteve sipërfaqësore, plasaritje ose ndryshim të karakteristikave mekanike të enës, të cilat mund të dëmtojnë sigurinë e enës.

6.3.2 Saldimet në pjesët nën presion

a) Karakteristikat e saldimeve dhe të zonave afër tyre, duhet të jenë të njëjta me ato të materialeve të salduara dhe të jenë pa defekte sipërfaqësore ose të brendshme që dëmtojnë sigurinë e enëve.

b) Saldimet kryhen nga saldatorë të kualifikuar ose punëtorë që zotërojnë nivelin e përshtatshëm të përdorimit të aftësisë, në përputhje me proceset e miratuara të saldimeve. Provat e miratimit dhe kualifikimit kryhen nga organet e autorizuar të inspektimit.

c) Fabrikuesi gjatë prodhimit, siguron cilësi të qëndrueshme të saldimeve nëpërmjet testeve të duhura dhe duke përdorur procedura të përshtatshme. Këto teste pasqyrohen në një raport.

6.4 Vënia në përdorim e enëve

a) Enët shoqërohen me udhëzime të hartuara nga fabrikuesi, të cilat përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

i) të dhënat e përcaktuara në pikën 28 (b), me përjashtim të serisë identifikuese të enës;

ii) përdorimi i përcaktuar i enës;

iii) kërkesat e mirëmbajtjes dhe instalimit për sigurinë e enës.

b) Udhëzimet jepen në gjuhën shqipe.

7. Ena, në të cilën prodhimi i PS me V është i barabartë ose më pak se 50 bar L, prodhohet në përputhje me praktikat e fushës inxhinierike në Republikën e Shqipërisë dhe mban mbishkrimet siç janë përcaktuar në pikën 28 (b), me përjashtim të markës “CE”.

8. Ena që mban markën “CE” prezumohet në përputhje me të gjitha pikat e këtij rregulli teknik, përfshirë dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në pikat 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37.

9. Përputhshmëria e enës me standardet e harmonizuara shqiptare prezumon përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 6.

10. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut prezumon se, ena për të cilën fabrikuesi nuk ka zbatuar, ose i ka zbatuar pjesërisht standardet e harmonizuara shqiptare, ose kur standarde të tilla nuk ekzistojnë, është në përputhje me kërkesat thelbësore përmendur në pikën 6, ku mbas marrjes së një certificate ekzaminimi të tipit CE, përputhshmëria e enës me modelin e aprovuar certifikohet nëpërmjet vendosjes së markës CE.

11. Kur ena është objekt i rregullave të tjera teknike që mbulojnë aspekte të tjera dhe që parashikojnë, gjithashtu vendosjen e markës CE, kjo e fundit tregon që ena në fjalë prezumohet se është në përputhje edhe me dispozitat e këtyre rregullave të tjera teknike.

12. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, kur konstaton se ena që ka markën “CE”, e përdorur në përputhje me destinacionin e përcaktuar, mund të rrezikojë sigurinë e njerëzve, kafshëve shtëpiake apo pronës, merr të gjitha masat për tërheqjen e këtij produkti nga tregu, apo për të ndaluar ose kufizuar vendosjen në treg.

13. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut informon menjëherë ministrinë për secilën nga masat e përmendura në pikën 12, duke treguar arsyet e një vendimi të tillë dhe në mënyrë të veçantë nëse moskonformiteti është për shkak:

a) të mosplotësimit të kërkesave thelbësore të përcaktuara në pikën 6, në rast se ena nuk është në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare;

b) të zbatimit të gabuar i standardeve;

c) të mangësive të vetë këtyre standardeve.

14. Enët, në të cilat prodhimi i PS me V e kalon 50 bar L, përpara se të prodhohen:

a) në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare, fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij zgjedh:

i) të informojë organin e autorizuar inspektues, siç përshkruhet në pikën 17 të këtij rregulli teknik, i cili mbas ekzaminimit të të gjithë dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 28, harton një certificate përshtatshmërie, duke vërtetuar që ky dokumentacion është i kënaqshëm, ose;

ii) të paraqesë në organin e autorizuar inspektues një enë prototipe, për ekzaminimin tip “CE” siç është përcaktuar në pikat 21, 22 dhe 23 të këtij rregulli teknik.

b) në mospërputhje ose përputhje të pjesshme me standardet e harmonizuara shqiptare, fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i paraqet organit të autorizuar inspektues një prototip të enës për ekzaminimin tip “CE”, siç është përcaktuar në pikat 21, 22, 23, 24, dhe 25 të këtij rregulli teknik.

15. Ena e prodhuar në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose me prototipin e miratuar, përpara se të vendosen në treg janë objekt:

a) i verifikimit “CE” në përputhje me pikën 26, 27 dhe 28 të këtij rregulli teknik, kur prodhimi i PS me V i kalon 3000 bar L;

b) i zgjedhjes së fabrikuesit, kur prodhimi i PS me V nuk kalon 3000 bar L, por është më i lartë se 50 bar/litër:

i) deklarim të konformitetit në përputhje me pikën 30 të këtij rregulli teknik;

ii) ose i verifikimit “CE” në përputhje me pikën 26, 27 dhe 28 të këtij rregulli teknik.

16. Dokumentacioni dhe korrespondenca që kanë lidhje me procedurat e certifikimit të shprehura në paragrafin a dhe b të kësaj pike, hartohen në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të pranueshme nga organi i autorizuar.

17. Ministri, në përputhje me ligjin nr.9779, datë 16.7.2007 “Mbi sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të produkteve joushqimore”, neni 14, autorizon organet përkatëse të vlerësimit të konformitetit për kryerjen e procedurave të përcaktuara në pikën 14, paragrafi “a” dhe “b” së bashku me detyrat e veçanta për të cilat janë parashikuar këto

organe në pikën 19 të këtij rregulli teknik, si dhe u cakton atyre numrat e identifikimit.

18. Një listë e organeve të autorizuar publikohet në Fletoren Zyrtare, së bashku me numrat e identifikimit të tyre dhe detyrat, për të cilat ata janë autorizuar.

19. Kriteret minimale për organet e autorizuar janë, si më poshtë:

a) Organi i inspektimit, drejtori i saj, si dhe personeli përgjegjës për kryerjen e testeve të verifikimit, nuk duhet të jenë projektuesi, prodhuesi, furnizuesi dhe as instaluesi i enëve që ata inspektojnë, si dhe asnjë përfaqësues i autorizuar nga këto palë.

b) Organi i inspektimit, drejtori i saj, si dhe personeli përgjegjës për kryerjen e testeve të verifikimit, nuk përfshihen drejtpërdrejt në projektimin, konstruksionin, tregtimin dhe mirëmbajtjen e enëve dhe as përfaqësojnë palët e angazhuara në këto aktivitete. Kjo nuk pengon mundësinë e shkëmbimit të informacionit teknik ndërmjet prodhuesit dhe organit të inspektimit.

c) Organi i inspektimit dhe personeli i tij kryejnë verifikimin e testeve me një shkallë të lartë të integritetit profesional dhe kompetencës teknike dhe duhet të jetë i lirë nga të gjitha presionet dhe ndërhyrjet, veçanërisht financiare, të cilat mund të influencojnë në gjykimin e tyre ose në rezultatet e inspektimit, në mënyrë të veçantë nga persona ose grupe personash të interesuar në rezultatet e verifikimeve.

d) Organi i inspektimit duhet të ketë në dispozicion të tij personelin dhe të zotërojë pajisjet e nevojshme për të bërë të mundur kryerjen siç duhet të detyrave administrative e teknike, të lidhura me verifikimin. Gjithashtu, të ketë mundësinë e përdorimit të pajisjeve të kërkuara për verifikime të veçanta.

e) Personeli përgjegjës për inspektimin duhet të ketë:

i) trajnime teknike dhe profesionale;

ii) njohuri të kënaqshme në lidhje me kërkesat e testeve që kryhen, si dhe eksperiencën e nevojshme për këto teste;

iii) aftësinë për hartimin e certifikatave, procesverbaleve dhe raporteve të kërkuara, për të vërtetuar kryerjen e testeve.

f) Garantimi i paanshmërisë së personelit të inspektimit. Pagesa e tyre nuk duhet të varet nga numri i testeve të kryera dhe as nga rezultatet e këtyre testeve.

g) Organi inspektues pajiset me sigurimin e përgjegjësisë, në përputhje me neni 14, paragrafi 2/d të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

h) Personeli i organit të inspektimit është i detyruar të ruajë fshehtësinë profesionale, në lidhje me të gjithë informacionin e marrë për kryerjen e detyrave të tij, sipas dispozitave këtij rregulli teknik, si dhe të çdo ligji tjetër që ka efekte për këtë.

20. Ministri tërheq autorizimin e organit të autorizuar në qoftë se konstaton se ai nuk plotëson më kriteret e përcaktuara në pikën 19.

21. Ekzaminimi tip “CE” është procedura, me anë të së cilës, organi i autorizuar inspektues verifikon dhe certifikon se një prototip ene plotëson dispozitat e këtij rregulli teknik, i cili zbatohet për këtë enë.

22. Aplikimi për ekzaminimin tip “CE” paraqitet nga fabrikuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, vetëm për një organ të autorizuar inspektues në lidhje me një prototip ene ose me një prototip përfaqësues të një familje të enës.

Aplikimi përfshin:

a) emrin dhe adresën e fabrikuesit apo përfaqësuesit të tij të autorizuar, si dhe vendin e prodhimit të enës;

b) Dokumentacionin teknik të projektit dhe të prodhimit siç është përcaktuar në pikën 28.

Aplikimi shoqërohet nga një enë e cila përfaqëson prodhimin në fjalë.

23. Organi i autorizuar inspektues duhet të kryejë ekzaminimin tip “CE” në mënyrën që përshkruhet më poshtë:

a) Ky organ për kontrollin e përputhshmërisë të enës shqyrton jo vetëm dokumentacionin i projektit dhe prodhimit, por gjithashtu edhe vetë enën e paraqitur.

b) Organi i autorizuar inspektues kur kontrollon enën:

i) verifikon, që ena është prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik të projektit dhe të prodhimit dhe mund të përdoret e sigurt sipas kushteve të përcaktuara të punës;

ii) kryen ekzaminimet dhe testet e duhura për të kontrolluar që ena përputhet me kërkesat

thelbësore të zbatueshme mbi të.

24. Në qoftë se prototipi përputhet me dispozitat të zbatueshme mbi të, organi i autorizuar inspektues harton një certifikatë ekzaminimi tip “CE”, e cila i jepet aplikantit. Kjo certifikatë deklaron përfundimet e ekzaminimit, tregon kushtet për të cilat është lëshuar, si dhe shoqërohet nga përshkrimet dhe vizatimet e nevojshme për identifikimin e prototipit të aprovuar.

25. Një organ i autorizuar që refuzon të lëshojë një certifikatë ekzaminimi tip “CE” informon për këtë organet e tjera të autorizuar. Një organ i autorizuar, që tërheq certifikatën e ekzaminimit tip “CE” informon ministrinë.

26. Verifikimi “CE” është procedura nëpërmjet të cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, garanton dhe deklaron që enët, të cilat janë kontrolluar sipas pikës 29, përputhen me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit tip “CE” ose me dokumentacioni teknik të projektit dhe të prodhimit, përcaktuar në pikën 28 duke marrë një certifikatë përshtatshmërie.

27. Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit të garantojë që të gjitha enët janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit tip “CE” ose me dokumentacionin e projektit dhe të prodhimit të përcaktuar në pikën 28. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij i vendos markën “CE” çdo ene dhe harton një deklaratë konformiteti.

28. Dokumentacioni teknik i projektit dhe i prodhimit përmban një përshkrim të teknikave dhe mënyrave të përdorura për të plotësuar kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikën 6 ose me standardet e harmonizuara shqiptare, në mënyrë të veçantë:

- a) vizatimet teknike të detajuara të prodhimit të tipit të enës;
- b) udhëzimet;
- c) dokumentet që përshkruan:
 - i) materialet e zgjedhura;
 - ii) proceset e zgjedhura të saldimit;
 - iii) kontrollet e zgjedhura;
 - iv) çdo veçanti tjetër që lidhet me projektin e enës.

d) kur përdoren procedurat e përcaktuara sipas pikave 26, 27, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37, dokumentacioni përmban, gjithashtu:

i) certifikatat që kanë të bëjnë me kualifikimin e përshtatshëm të proceseve të saldimit, si dhe të saldatorëve apo punëtorëve;

ii) fleta e inspektimit për materialet e përdorura në prodhimin e pjesëve dhe bashkimeve që kontribuojnë në forcimin e enës;

iii) një raport mbi ekzaminimet dhe testet e kryera ose një përshkrim i kontrolleve të propozuara.

29. Organi i autorizuar kryen ekzaminimet dhe testet e duhura për të kontrolluar përputhshmërinë e enëve me kërkesat e këtij rregulli teknik, duke ekzaminuar dhe testuar enët sipas paragrafëve të mëposhtëm:

a) Fabrikuesi paraqet enët në formën e partive të njëjta dhe merr të gjitha masat që procesi i prodhimit të sigurojë njëtrajtshmërinë e çdo partie të prodhuar.

b) Këto parti shoqërohen me certifikatën e ekzaminimit tip “CE” të përcaktuar në pikat 21, 22, 23, 24 dhe 25, ose, në rast se enët nuk janë prodhuar në përputhje me një prototip të miratuar, me dokumentacionin e projektimit dhe të prodhimit, të përcaktuar në pikën 28. Në këtë rast, organi i autorizuar përpara verifikimit “CE”, shqyrton dokumentacionin teknik për të certifikuar përputhshmërinë e tij.

c) Kur ekzaminohet një parti, organi i autorizuar inspektues garanton që enët janë prodhuar dhe kontrolluar në përputhje me dokumentacionin e projektit dhe të prodhimit, dhe për të kontrolluar saktësinë kryen një test hidrostatik ose pneumatik me një efekt të njëjtë, në çdo ene të partisë, me një presion 1,5 herë më të madh se presioni i projektimit të enës. Testi pneumatik është objekt i miratimit të procedurave të testit të sigurisë, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë:

i) organi i autorizuar inspektues kryen teste mbi kampione prove të marra nga një mostër përfaqësuese e prodhimit ose nga një ene e zgjedhur nga fabrikuesi, për të kontrolluar cilësinë e saldimit. Testet kryhen në saldimet gjatësore. Megjithatë, në rast se janë përdorur teknika të ndryshme saldimi, gjatësore dhe rrethore, testet përsëriten për saldimet rrethore;

ii) për enët e përmendura në pikën 6.2.1 (d), testet mbi kampionet-provë zëvendësohen me një

test hidrostatik mbi pesë enë të marra rastësisht nga çdo parti, për të kontrolluar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e pikës 6.2.1 (d).

d) Në rastin e partive të pranuara, organi i autorizuar inspektues vendos ose kërkon të jetë i vendosur numri i tij i identifikimit në çdo enë dhe harton një certifikatë konformiteti me shkrim, në lidhje me testet e kryera. Të gjitha enët në parti mund të vendosen në treg përveç atyre që nuk e kanë kaluar me sukses testin hidrostatik ose pneumatik:

i) në rast se një parti, pas shqyrtimit nga organi i autorizuar inspektues, nuk rezulton në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, ky organ ose struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr masat e duhura për të parandaluar vendosjen në treg të asaj partie;

ii) në rast mospërputhje të përsëritur, organi i autorizuar inspektues mund të pezullojë verifikimin statistikor;

iii) fabrikuesi gjatë procesit të prodhimit, nën përgjegjësinë e organit të autorizuar, vendos numrin e identifikimit të këtij organi.

e) Me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, personi që vendos në treg enën duhet të jetë në gjendje të sigurojë certifikatat e konformitetit e lëshuara nga organi i autorizuar inspektues, të përcaktuar në pikën 29 (d).

30. Fabrikuesi që përmbush detyrimet që rrjedhin nga pikat 33 dhe 34 të këtij rregulli teknik, vendos markën “CE”, në përputhje me pikat 38, 39, 40 për enët që ai deklaron se janë në përputhje me:

a) dokumentacionin teknik të projektit dhe të prodhimit të përcaktuar në pikën 28 dhe për të cilin është hartuar një certifikatë përshtatshmërie; ose

b) prototipin e miratuar.

31. Nga ky deklaram i procedurave të konformitetit, fabrikuesi bëhet subjekt i mbikëqyrjes “CE”, në rastet kur prodhimi i PS me V kalon 200 bar L. Qëllimi i mbikëqyrjes CE është që të garantojë, siç kërket në pikën 36 të këtij rregulli teknik, që fabrikuesi plotëson si duhet detyrimet që rrjedhin nga pika 34 e këtij rregulli teknik.

32. Mbikëqyrja “CE” kryhet nga organi i autorizuar inspektues i cili ka lëshuar certifikatën e ekzaminimit tip “CE” në përputhje me pikat 21, 22, 23 dhe 24 të këtij rregulli teknik, në rast se enët janë prodhuar në përputhje me prototipin e miratuar, ose nga organi i autorizuar inspektues, të cilit i është dërguar dokumentacioni teknik i projektit dhe i prodhimit në përputhje me pikën 14 (a/i).

33. Kur fabrikuesi vë në përdorim procedurën e përcaktuar në pikën 30 të këtij rregulli teknik, ai përpara fillimit të prodhimit i dërgon organit të autorizuar, i cili ka lëshuar certifikatën e ekzaminimit tip “CE” ose certifikatën e përshtatshmërisë, një dokument i cili përshkruan procesin e prodhimit dhe të gjitha masat sistematike të paravendosura, të marra për të garantuar përputhshmërinë e enës me standardet e harmonizuara shqiptare, apo me prototipin e miratuar.

Ky dokument përfshin:

a) një përshkrim të mjeteve të prodhimit dhe të kontrollit të duhur për ndërtimin e enës;

b) një dokument inspektimi, i cili përshkruan ekzaminimet dhe testet e duhura që kryhen gjatë prodhimit, së bashku me procedurat përkatëse dhe frekuencën e kryerjes së tyre;

c) marrjen përsipër të kryerjes së ekzaminimeve dhe testeve në përputhje me dokumentin e inspektimit, siç është përcaktuar në pikën 34 të këtij rregulli teknik dhe të kryerjes së një testi hidrostatik, ose në marrëveshje me organin e autorizuar të inspektimit, kryerjen e një testi pneumatik në secilën enë të prodhuar, në një presion prove me vlerë 1,5 herë më të madhe se presioni i projektimit.

Këto ekzaminime dhe teste të shoqëruara me një raport, kryhen nën përgjegjësinë e një stafi të kualifikuar, të cilët janë të pavarur në mënyrë të mjaftueshme nga personeli prodhues.

d) adresat e vendeve të prodhimit dhe magazinimit, si dhe data në të cilën ka filluar prodhimi.

34. Kur prodhimi i PS me V i kalon 200 bar L, fabrikuesi autorizon hyrjen në vendet e prodhimit dhe të magazinimit për qëllime inspektimi, të organit përgjegjës për mbikëqyrjen CE, dhe e lejon këtë organ të zgjedhë mostra enësh, si dhe i siguron të gjithë informacionin e nevojshëm, dhe në mënyrë të veçantë:

a) dokumentacionin teknik të projektimit dhe të prodhimit;

b) raportin e inspektimit;

c) certifikatën e ekzaminimit tip “CE” ose certifikatën e përshtatshmërisë, nëse është e

nevojshme;

d) një raport mbi ekzaminimet dhe testet e kryera.

35. Organi i autorizuar inspektues, i cili lëshon certifikatën e ekzaminimit tip “CE” ose certifikatën e përshtatshmërisë, përpara datës në të cilën fillon prodhimi, kontrollon dokumentin që përcaktohet në pikën 34 të këtij rregulli teknik, ashtu edhe dokumentacionin e projektit dhe të prodhimit, të përcaktuar në pikën 28, për të certifikuar përputhshmërinë e enëve, nëse enët nuk janë prodhuar në përputhje me një prototip të miratuar.

36. Kur prodhimi i PS me V i kalon 200 bar L, organi i autorizuar inspektues gjatë prodhimit:

a) garanton që, fabrikuesi faktikisht kontrollon enët e prodhuara në seri në përputhje me pikën 33 (c) të këtij rregulli teknik;

b) merr mostra enësh të rastësishme në vendet e prodhimit ose të magazinimit të tyre, për qëllime inspektimi.


37. Organi i autorizuar inspektues i paraqet ministrisë, dhe sipas kërkesës edhe organeve të tjera të autorizuara, një kopje të raportit të inspektimit.

38. Marka “CE” dhe mbishkrimet e bëra sipas pikës 39, duhet të vendosen në enë në formë të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe të paheqshme ose mbi një pllakë të dhënash të ngjitur mbi enë e cila është vendosur në të në një formë të paluajtshme (pashkëputshme).

39. Marka “CE” konsiston në inicialet “CE”, në formën e dhënë sipas modelit të mëposhtëm, marka “CE” shoqërohet nga numri identifikimit të organit të autorizuar inspektues, përgjegjës për verifikimin “CE” ose mbikëqyrjen “CE”, përcaktuar në pikën 17 të këtij rregulli teknik.

39.1 Marka e konformitetit “CE”

i) Marka e konformitetit “CE” përbëhet nga inicialet “CE” në formën e mëposhtme:



ii) Në rast se marka “CE” zvogëlohet ose zmadhohet, përmasat e dhëna në vizatimin e shkallëzuar më lart duhet të respektohen.

iii) Komponentët e ndryshueshëm të markës “CE” që kanë kryesisht të njëjtën përmasë vertikale, nuk mund të jetë më pak se 5 mm.

39.2 Mbishkrimet

a) Ena ose pllaka e të dhënave përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

i) presioni maksimal i punës P_s në bar;

ii) temperatura maksimale e punës T_{max} në °C;

iii) temperatura minimale e punës T_{min} në °C;

iv) kapaciteti i enës V në L;

v) emri ose marka e fabrikuesit;

vi) tipi dhe seria ose identifikuesi i partisë së enës;

vii) dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur marka “CE”.

b) Nëse përdoret një pllakë të dhënash, projektohet e tillë që të mos ripërdoret dhe përmban hapësirë të lirë që të mund të pajiset me informacione të tjera.

40. Ndalohet vendosja e markave në enët që mund të sjellë mashtrimin e palëve të treta lidhur

me kuptimin dhe formën e markës “CE”. Çdo markë tjetër ose një pllakë të dhënash, mund të vendoset në enë, me kusht që dukshmëria dhe leximi i markës “CE” të mos cenohet.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 31.12.2007
Doli nga shtypi më 31.12.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 36 lekë